

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6297
E enjte, 22 prill 2021
çmimi 0.40 €

Qeveria ndan rreth 20 milionë euro për sektorë të ndryshëm

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | FAQE 4-5

OPOZITA TA ORIENTOJË OPOZITARIZMIN JASHTË KUVENDIT



Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka ftuar subjektet politike opozitare që aktivitetin e tyre ta orientojnë jashtë Kuvendit për ta kritikuar qeverinë. Në këtë intervistë

dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se me numrat që ka opozita në Kuvend nuk do të mund ta sfidojnë punën e qeverisë Kurti. Sipas tij, në aktivitetin e tyre opozitar PDK-ja,

LDK-ja dhe AAK-ja duhet të bashkohen dhe të hartojnë një platformë të bashkëpunimit në të cilën duhet të përfshihen të gjitha proceset që e presin Kosovën

RRETH 20 MIJË PERSONA VAKSINOHEN KUNDËR COVIDIT NË KOSOVË



Deri të mërkurën në nivel vendi janë vaksinuar rreth 20 mijë persona në Kosovë. Në këtë numër përfshihen punonjësit shëndetësorë, të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike | FAQE 7

HOXHAJ: NJË MUAJ QEVERISJE PA PLAN | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepgisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KMSHK-ja dhe AGK-ja KUNDËRSHTOJNË QË MEDIAT ONLINE TË JENË PJESE E LIGJIT PËR KPM-në | F. 8

KONJUFCA DHE BREGU DISKUTUAN PËR TREGUN E PËRBASHKËT EKONOMIK DHE LËVIZJEN E LIRË | F. 5

KRYHEN PESË OPERACIONE KARDIOKIRURGIKE TE FËMIJËT ME DEFEKTE NË ZEMËR | F. 7

EKONOMI



AGRON LLUGALIU EMËROHET DREJTOR I PËRGJITHSHËM I DOGANËS | F. 9

KOSOVA GJATË VITIT 2020 RRITI EKSPORTIN NË 460 MILIONË EURO | F. 9

SPORT

LLAPI KUALIFIKOHET NË FINALE TË KUPËS | F. 10

KASTRATI: NDER DHE KËNAQËSI TË LUAJA NË LIGËN UNIKE | F. 10

Një i vrarë dhe tre të plagosur në Elbasan

ELBASAN, 21 PRILL - Një person është vrarë dhe tre të tjerë kanë mbetur të plagosur si pasojë e të shtënave me armë në qytetin e Elbasanit të mërkurën. Një nga të plagosurit është një pjesëtare e Policisë së Shqipërisë.

Mësohet se personi i vrarë është Pjerin Xhuvani, 56 vjeç, ish-zyrtar i Lëvizjes Socialiste në Elbasan.

Ngjarja ndodhi rreth orës 14:20 në lagjen "5 maji", pas një përplasjeje me armë mes të paktën gjashtë personave, pranë zyrave të Partisë Demokratike në këtë qytet. Sipas raportimeve paraprake, vrasësi i Xhuvanit është Arbër Papeleka, i cili mësohet se është edhe truproja i Gazmend Bardhit, koordinatorit të Partisë Demokratike në Elbasan, por

edhe ish-pjesëtar i forcave speciale të policisë RENEA.

Ai është arrestuar nga Policia e Shqipërisë.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka folur për ngjarjen e sotme, ku tha për mediat se qarku i Elbasanit është një nga rajonet më problematike në Shqipëri. "Ajo që është shqetësues në Elbasan është se shumica e krimeve zgjedhore deri tani që janë denoncuar i takojnë qarkut të Elbasanit", tha Meta.

Ai u bëri thirrje institucioneve për zbatimin e ligjit të jenë në krye të detyrës dhe të shkëpusin çdo lidhje apo preferencë partiake. "Organet ligjzbatuese të shkëpusin çdo preferencë partiake dhe pa dyshim do të mbajnë përgjegjësi për ngjarjet e rënda



që po regjistrohen në vend, sepse vendi nuk ka nevojë për viktima por, mbi të gjitha, vendi

nuk ka nevojë për asnjë lloj cenimi të standardeve zgjedhore. Me qetësi dhe

dashuri të nisen [qytetarët] drejt 25 prillit", ka theksuar Meta.

Mali i Zi arreston kreun e dyshuar të një bande kriminale



PODGORICË, 21 PRILL - Policia e Malit të Zi ka arrestuar kreun e dyshuar të një bande kriminale e cila ka përhapur frikë dhe gjakderdhje në Ballkan dhe në të gjithë Evropën, thanë zyrtarët të mërkurën.

Arrestimi i Sllobodan Kashçelan ndodhi në qytetin bregdetar të Kotorit.

Zëvendëskryeministri Dritan Abazović e ka përshëndetur arrestimin e tij duke e paraqitur si suksesin më të madh të policisë në dhjetë vjetët e fundit.

Kashçelan, 58 vjeç, u arrestua nën dyshimet për organizim të grupit kriminal

që ka kryer dhe po planifikonte akte të rënda kriminale, thanë mediat e Malit të Zi.

Kashçelan supozohet se është udhëheqës i një klani kriminal, i cili që nga viti 2015 është përfshirë në një luftë të përgjakshme me një bandë rivale malazeze për kontrollin e kontrabandës së kokainës nga Amerika e Jugut.

Dy bandat kishin filluar sulme vdekjeprurëse kundër njëra-tjetrës në Mal të Zi, Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe në vendet evropiane Greqi, Spanjë dhe Itali.

Kashçelan u ka mbijetuar dy

përpjekjeve për vrasje, përfshirë atë të vitit 2016 kur ai u plagos rëndë në qytetin verior serb të Novi Sadit.

Qeveria e re e Malit të Zi që fitoi pushtetin pas zgjedhjeve parlamentare në gusht të vitit 2020 është zotuar se do t'i çrrënjosë krimin dhe korrupsionin.

Zëvendëskryeministri Abazović ka thënë se arrestimi i Kashçelan është vetëm fillimi i luftës së qeverisë kundër kimit. "Ne kemi premtuar se Mali i Zi nuk do të drejtohet nga mafia dhe ne jemi duke e përmbushur atë premtim", ka thënë Abazović.

Gjermania synon tërheqjen nga Afganistani deri më 4 korrik

BERLIN, 21 PRILL - Gjermania është duke shqyrtuar planet për të caktuar një datë të tërheqjes së trupave nga Afganistani, raportojnë mediat.

Një zëdhënës i Ministrisë së Mbrojtjes së Gjermanisë ka thënë se ligjvënësit janë informuar për planet dhe se po zhvillohen konsultimet edhe me aleatët e NATO-s. "Po e konsiderojmë datën 4 korrik për tërheqjen e forcave", i tha agjencisë AFP një zëdhënës i ministrisë, duke theksuar se vendimi përfundimtar do të merret nga NATO-ja.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, javën e kaluar njoftoi për tërheqjen e trupave amerikane nga Afganistani deri me 11 shtator. Ky afat është katër muaj më vonë se afati paraprak i vendosur nga administrata e mëparshme amerikane e cila kishte arritur një marrëveshje me kryengritësit talibanë.

Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Annegret Kramp-Karrenbauer, më parë kishte caktuar mesin e gushtit si afatin e fundit për largimin e trupave të vendit të saj. Sipas



marrëveshjes së arritur në Doha, midis zyrtarëve të administratës së mëparshme amerikane dhe talibanëve, të

gjitha forcat e huaja do të duhej të largoheshin nga Afganistani deri më 1 maj. Në këmbim të kësaj, grupi

militant ka dhënë garanci se do t'i ndërpresë lidhjet me Al-Kaidën dhe do ta refuzojë strehimin e terroristëve të huaj.

Talibanët, gjithashtu, u zotuan të negocionë një armëpushim dhe një marrëveshje për ndarjen e pushtetit me qeverinë afgane. Më 21 prill Turqia tha se është shtyrë një konferencë ndërkombëtare e paqes për Afganistanin e planifikuar për këtë javë. Zyrtarët afganë dhe përfaqësuesit e talibanëve nuk i kanë komentuar arsyet e shtyrjes.

Hoxhaj: Një muaj qeverisje pa plan

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 PRILL - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë të mërkurën se po bëhet një muaj që qeveria Kurti ka marrë detyrën dhe ende nuk ka prezantuar një plan qeverisës. Hoxhaj ka thënë se kjo qeveri po merret me improvizime dhe me vendime të paqarta. "Improvizime, manipulime, vendime të përçarta e asnjë vizion se si të përballen me pandeminë, ekonominë e arsimin. Kjo qeveri po abstenon nga puna dhe përgjegjësia. Albin Kurti është fshehur prapa protokolleve dhe takimeve zyrtare me ata që dikur veturave të tyre ua fuste flakën, ndërsa as edhe një fjalë apo veprim konkret për t'u dalë në ndihmë qytetarëve në këtë periudhë të vështirë. E për t'i mbuluar

të gjitha dështimet, Kurti nisi edhe luftën dhe përndjekjen e mediave të cilat guxuan të flasin për keq-qeverisjen e tij", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka thënë se kryeministri Kurti duhet të zbresë deri në QKUK. "Sot mungojnë shumica e barnave esenciale, se për vaksina të mos flasim, e ta shoh gjendjen reale të qeverisjes së tij. Qytetarët, përveç problemeve shëndetësore, po sfidohen edhe ekonomikisht duke blerë gjithçka nga ilaçet dhe materialet shpenzuese. Kurti edhe mund të mos i dijë këto informata nga terreni, por e ftoj dikë nga oborrtarët e tij që, nëse ka guxim, t'ia hapë sytë me disa doza realiteti", ka thënë Hoxhaj.

Me kërkesë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kuvendi i Kosovës të hënën do të debatojë për gjendjen e pandemisë Covid-19.



Edhe shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka thënë se nuk po shihet ndonjë angazhim i qeverisë për t'i mbështetur institucionet shëndetësore.

"Të vdesin 14 ose 15 qytetarë në ditë është gjendje alarmante. Ne po shohim që spitalet tona janë të stërmëshura dhe nuk po shohim një angazhim më të madh të Qeverisë së Kosovës

dhe Ministrisë së Shëndetësisë për fuqizimin dhe mbështetjen e institucioneve shëndetësore", ka deklaruar Tahiri pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit që është mbajtur një ditë më herët.

Qeveria ndan rreth 20 milionë euro për sektorë të ndryshëm



PRISHTINË, 21 PRILL - Qeveria e Kosovës ka ndarë rreth 20 milionë euro për sektorë të ndryshëm që kanë pësuar humbje nga masat e qeverisë për parandalimin e

pandemisë së koronavirusit dhe punonjësve që kanë pasur angazhim të shtuar gjatë përballjes me pandeminë e Covid-19. Në mbledhjen e mbajtur të

mërkurën, Qeveria e Kosova ka ndarë 6 milionë euro për bizneset të cilat kanë pësuar humbje nga masat e fundit të qeverisë, 7-19 prill, të cilët kanë ndaluar apo

pezulluar punën. Me këtë shumë do të subvencionohen pagat e punëtorëve dhe 50 për qind e pagesës së qirave. Hekuran Murati, ministër i

Financave, Punës dhe Transfereve, ka thënë se "vendimi ka për qëllim ka t'i subvencionojë shpenzimet operative bazë të biznesit sikurse janë pagat dhe qiratë deri në 50 për qind".

Kurse për punonjësit shëndetësorë dhe ata të sigurisë janë ndarë 5.2 milionë euro. Me nga 150 euro në muaj do të paguhet mjekët dhe infermierët dhe me nga 100 euro stafi teknik. Ndërkaq, 8.5 milionë euro janë ndarë për skemat sociale.

Mjetet e ndara janë në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike. Ky program, që paraqitet në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, kap vlerën 222 milionë euro. Deri më tani nga ky ligj nga qeveria e kaluar janë ndarë rreth 100 milionë euro.

Ministri gjerman i Punëve të Jashtme viziton sot Kosovën

PRISHTINË, 21 PRILL - Shefi i diplomacisë gjermane, Heiko Maas, të enjten do ta vizitojë Prishtinën, ka njoftuar Ministria e Punëve të Jashtme e Gjermanisë në Berlin. Një ditë më vonë Maas do ta vizitojë edhe Beogradin. Sipas zëdhënëses së kësaj ministrie, Maria Adebahr, Maas do të diskutojë me zyrtarë të Kosovës dhe Serbisë edhe për dialogun për

normalizimin e marrëdhënieve. Vizita e shefit të diplomacisë gjermane vjen pas raportimeve mediale në rajonin e Ballkanit Perëndimor lidhur me mundësinë e ndryshimit të kufijve në mes të shteteve. Siç kanë raportuar disa media, kryeministri i Sllovenisë, Janez Jansha, i ka dorëzuar Brukselit zyrtar të ashtuquajturën "non-paper",

ku thuhet se procesi i dezintegrimit të ish-Jugosllavisë nuk është finalizuar.

Qeveria gjermane ka reaguar lidhur me këto raportime dhe i ka hedhur poshtë këto ide. Ministri gjerman për Evropën, Michael Roth, ka thënë përmes një shkrimi publikuar në "Twitter" se idenë e ndryshimit të kufijve e konsideron të "rrezikshme".





FLET PËR “EPOKËN E RE”, BEHXHET SHALA

Opozita ta orientojë opozitarizmin jashtë Kuvendit

Njohësi i proceseve politike në vend, Behxhet Shala, ka ftuar subjektet politike opozitare që aktivitetin e tyre ta orientojnë jashtë Kuvendit për ta kritikuar qeverinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se me numrat që ka opozita në Kuvend nuk do të mund ta sfidojnë punën e qeverisë Kurti. Sipas tij, në aktivitetin e tyre opozitar PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja duhet të bashkohen dhe të hartojnë një platformë të bashkëpunimit në të cilën duhet të përfshihen të gjitha proceset që e presin Kosovën

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINE, 21 PRILL - Analisti politik Behxhet Shala ka bërë me dije se subjektet opozitare nuk janë duke e sfiduar qeverinë Kurti. Ai ka thënë se numrat e paktë në Kuvend të subjekteve politike opozitare pamundësojnë rrezikimin e qeverisë brenda Kuvendit.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Shala ka thënë se

opozita duhet ta orientojë aktivitetin opozitar jashtë Kuvendit. “Partitë opozitare nuk janë duke bërë kurrfarë opozite. PDK-ja është larg të bërit opozitë konstruktive dhe konkurruese. LDK-ja duket se ka rënë në gjumë. AAK-ja ka pak vota në Kuvend për të bërë opozitë. E vetmja parti që deri më tani po bën opozitë është PSD-ja. Po e them me përgjegjësi se opozita edhe nëse bëhet bashkë nuk ka mundësi të bëjë një aktivitet

opozitar brenda Kuvendit sepse nuk i ka numrat e duhur. Opozita duhet ta orientojë aktivitetin opozitar jashtë Kuvendit”, ka thënë Shala.

Ai ka ftuar subjektet politike opozitare që të koordinohen mes vete dhe ta bëjnë një platformë të përbashkët për ta kundërshtuar qeverinë. “Këto parti duhet të ulen të bisedojnë dhe të përpiqen të hartojnë një platformë të bashkëpunimit të veprimit opozitar. Në këtë platformë

duhet të përfshihen proceset që e presin Kosovën, si dialogu me Serbinë, pandemia, rimëkëmbja ekonomike etj”, është shprehur ai.

Shala ka thënë se qeveria shumë shpejt duhet ta paraqesë planin qeverisës. Ai ka thënë se në kushtet që është Kosova nuk duhet të pritët shumë nga kjo qeveri. “Në rrethanat ekzistuese as pritjet e mia nuk janë të mëdha sepse nuk ka kushte ekonomike që të realizohen ato që i ka premtuar Kurti në fushatë sepse edhe vendeve me ekonomi të zhvilluar pandemia ua ka pamundësuar çdo plan zhvillimor. Qeveria e re duhet ta bëjë një riprogramim të premtimeve që i ka dhënë. Pra në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe politike të caktojë të tjera prioritete sepse

nuk ka mundësi t’i realizojë premtimet që i ka dhënë gjatë fushatës zgjedhore”, ka thënë Shala. Ai ka treguar se sfidë e vërtetë e kësaj qeverie do të jetë dialogu me Serbinë. “Kurti ka trashëguar shumë probleme nga procesi i dialogut. Ai tani duhet të merret me rikuperimin e atyre problemeve. Dihet që Albin Kurti nuk mund t’i kundërshtojë marrëveshjet ndërkombëtare. Siç dihet, ato janë të panegociueshme për ndërkombëtarët dhe të pakthyeshme. Tani të gjithë po e përmendin një marrëveshje me Serbinë, por gjithnjë po përmendet kompromisi. Ende nuk dihet se çfarë përmban ai kompromisi”, ka thënë Shala.

“Epoka e re”: Z. Shala, po bëhet një muaj që qeveria Kurti ka



marrë detyrën, por ende nuk e ka paraqitur planin qeverisës. Si e ke parë punën e kësaj qeverie deri më tani?

Shala: Një muaj është kohë e shkurtër për ta vlerësuar punën e një qeverie. Për të bërë një vlerësim fillestar të punës së qeverisë së pari duhen parë ato 100 ditët e punës së saj. Albulena Haxhiu ka bërë me dije se planin e tyre qeverisës do ta dorëzojnë të premten dhe të shohim se si do të jetë ky plan. Ne jemi në një situatë të jashtëzakonshme, pra në një situatë të tillë nuk mund të presësh rezultate të shpejta dhe nuk mund të sillesh në mënyrë të zakonshme. Kjo qeveri e ka trashëguar një gjendje të vështirë për shkak të pandemisë e cila ka vështirësuar jetën në të gjitha aspektet. Prioritete të kësaj qeverie duhet të jenë lufta ndaj pandemisë dhe rimëkëmbja ekonomike. Nëse qeveria Kurti brenda një afati prej dy javësh nuk e paraqet programin qeveritar atëherë nuk do të jetë në rregull. Kurti gjatë fushatës zgjedhore në pika të shkurtra i ka treguar synimet dhe objektivat e tij. Qeveria duhet të gjejë mënyra se si t'u ndihmojë bizneseve dhe qytetarëve të prekur nga pandemia.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet tua nga kjo qeveri?

Shala: Gjatë fushatës zgjedhore çdo parti jep premtime të cilat e

dinë se nuk do të mund t'i realizojnë. Nga premtimet që i ka dhënë Kurti në fushatën zgjedhore pritjet janë të mëdha dhe në bazë të atyre pritjeve ka fituar mbi 50 për qind të votave. Tani ai duhet ta gjejë një mënyrë se si t'i realizojë ato premtime. Natyrisht se të gjitha ato premtime nuk do të realizohen, por prioritete duhet të jetë pandemia, rimëkëmbja dhe hapja e vendeve të reja të punës. Pavarësisht prej premtimeve që ka dhënë, problemi do të jenë bisedimet me Serbinë, sepse këtu nuk do ta këtë përkrahjen e opozitës. Në rrethanat ekzistuese as pritjet e mia nuk janë të mëdha, sepse nuk ka kushte ekonomike që të realizohen ato që i ka premtuar Kurti në fushatë, sepse edhe vendeve me ekonomi të zhvilluar pandemia ua ka pamundësuar çdo plan zhvillimor. Qeveria e re duhet ta bëjë një riprogramim të premtimeve që i ka dhënë. Pra, në përputhje me zhvillimet ekonomike dhe politike, të caktojë të tjera prioritete, sepse nuk ka mundësi t'i realizojë premtimet që i ka dhënë gjatë fushatës zgjedhore.

"Epoka e re": Edhe opozita po e kritikon qeverinë Kurti. Cili është vlerësimi juaj për aktivitetin e deritanishëm të opozitës?

Shala: Partitë opozitare nuk janë duke bërë kurrfarë opozite. PDK-

ja është larg të bërit opozitë konstruktive dhe konkurruese. LDK-ja duket se ka rënë në gjumë. AAK-ja ka pak vota në Kuvend për të bërë opozitë. E vetmja parti që deri më tani po bën opozitë është PSD-ja. Po e them me përgjegjësi se opozita edhe nëse bëhet bashkë nuk ka mundësi të bëjë një aktivitet opozitar brenda Kuvendit sepse nuk i ka numrat e duhur. Opozita duhet ta orientojë aktivitetin opozitar jashtë Kuvendit. Gjithashtu, këto parti duhet të ulen të bisedojnë dhe të përipiqen të hartojnë një platformë të bashkëpunimit të veprimit opozitar. Në këtë platformë duhet të përfshihen proceset që e presin Kosovën, si dialogu me Serbinë, pandemia, rimëkëmbja ekonomike etj.

"Epoka e re": Mendoni se kjo opozitë nuk do të mund ta sfidojë këtë qeveri?

Shala: Kështu siç po bën opozita, qeveria Kurti nuk do të jetë e rrezikuar. Tani për tani vetëm emrin e ka opozitë dhe nuk është duke bërë asgjë. Është pritur që të bëhet një opozitë krejt tjetër. Kjo opozitë me asgjë nuk mund ta rrezikojë Kurtin dhe qeverinë e tij. Qeverinë aktuale mund ta rrezikojë vetëm Kurti nëse i has sharra në gozhdë gjatë bisedimeve me Serbinë ose nëse ai vetë nuk dëshiron ta zgjasë qeverisjen dhe dëshiron të shkojë

në zgjedhje të reja.

"Epoka e re": Pritet që shumë shpejt do të fillojë dialogu Kosovë - Serbi. Presidenti amerikan ka paralajmëruar se në këtë proces duhet të bëhen kompromise. Do të ndryshojë diçka në këtë proces?

Shala: Kurti ka trashëguar shumë probleme nga procesi i dialogut. Ai tani duhet të merret me rikuperimin e atyre problemeve. Albin Kurti nuk mund t'i kundërshtojë marrëveshjet ndërkombëtare. Siç dihet, ato janë të panegociueshme për ndërkombëtarët dhe të pakthyeshme. Tani të gjithë po e përmendin një marrëveshje me Serbinë, por gjithnjë po përmendet kompromisi. Ende nuk dihet se çfarë përmban ai kompromisi. Pra, a përbën asociacionin e komunave me shumicë serbe, i cili skajshmërisht e bën Kosovën jofunksionale apo përmban ndryshimin e kufijve. Për atë dokumentin slloven shumëkush po thotë se ka përmbajtje joserioze, por ata e lëshojnë një përmbajtje joserioze për ta testuar opinionin dhe pastaj ta prezantojnë në formën 'merre ose lëre'. Vetë fakti që Kosova është në defansivë dhe Serbia ka një avantazh të madh politik e diplomatik, tregon një paralajmërim jo të mirë për këtë proces.

Konjufca dhe Bregu diskutuan për tregun e përbashkët ekonomik dhe lëvizjen e lirë

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 PRILL - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në mërkurën në takim delegacionin e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, i kryesuar nga Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme, Amer Kapetanoviq, shef i Departamentit Politik dhe Pranvera Kastrati, eksperte e lartë për lidhje ekonomike dhe digjitale. Me këtë rast, kryekuvendari Konjufca ka konfirmuar gatishmërinë e Republikës së Kosovës për të kontribuar për realizimin e zotimeve dhe përgjegjësi si shtet pjesëmarrës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal dhe atë të Procesit të Berlinit. Ai ka thënë se vetëm angazhimi i përbashkët i të gjitha shteteve pjesëmarrëse në kuadër të këtij mekanizmi mund të sjellë përparimin e synuar dhe përmbushjen e zotimeve të dala nga Procesi i Berlinit, siç janë fuqizimi i institucioneve, forcimi i demokracisë, zhvillimi i inovacionit e digjitalizimit etj.

Konjufca ka theksuar se Kosova, siç dihet, gjendet në fazën e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe kjo i kontribuon përafritimit të politikave të përbashkëta publike drejt bashkimit në familjen evropiane. Ai i ka njoftuar anëtarët e delegacionit lidhur me krijimin e institucioneve të reja, të dala nga rezultati i zgjedhjeve të 14 shkurtit, stabilitetin politik në vend, si dhe luftën kundër pandemisë Covid-19, përfshirë përpjekjet e vendit tonë për vaksinimin e popullatës.

Ndërsa kryesuesja e delegacionit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Majlinda Bregu, e ka uruar Konjufcën për detyrën e re në krye të Kuvendit si dhe e ka njoftuar lidhur me prioritetet afatshkurtra në nivel rajonal, ndër të cilat tregu i përbashkët ekonomik, lëvizja e lirë dhe njohja reciproke e kualifikimeve akademike.

Palët, po ashtu, u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit për shtyrjen e agjendave të përbashkëta të Këshillit për



Bashkëpunim Rajonal, të dala nga Procesi i Berlinit.

Bregun e ka pritur në takim edhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për përparimin dhe rrugën e Kosovës drejt

integritet euroatlantik. Ministrja Gërvalla e ka njoftuar Bregun dhe përfaqësuesit e RCC-së me prioritetet e Kosovës karshi agjendës evropiane. Ajo e ka konsideruar të vlefshme secilën përpjekje që ndihmon vendet e Ballkanit të avancojnë në këtë drejtim dhe ka theksuar

se përfshirja e Kosovës mund të bëhet vetëm me një përfaqësim të barabartë të saj në të gjitha nismat. Nga ana tjetër, Bregu ka shpjeguar idenë e tregut të përbashkët rajonal me qëllim të krijimit të një rajoni më konkurrues dhe më afër tregjeve të Bashkimit Evropian.

Suspendohen dy zyrtarë policorë në Prizren



PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht hetuesit e Departamentit të Hetimeve të IPK-së, kanë rekomanduar suspendimin e dy zyrtarëve policorë me dyshimin se ata kanë kryer veprën penale "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar" nga neni 414 dhe "Ushtrim ndikimi" neni 424 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Hetimet lidhur me këtë rast

kanë filluar ditë më herët, ku hetuesit e IPK-së kishin pranuar informacione se dy zyrtarë policorë (komandanti i Stacionit të Prizrenit me gradën e majorit dhe komandanti i Nënstacionit Policor të Zhurit me gradën e rreshterit) kanë ndërhyrë pa autorizim në një gjobë për kundërvajtje në trafik me ç'rast dyshohet se janë ndryshuar neni dhe paragrafi, pastaj është ndryshuar vlera e gjobës. Dyshimet janë se

gjatë ndërhyrjes së paautorizuar janë larguar edhe pikët negative të shqiptuara si dhe është revokuar ndalesa për vozitje dhe konfiskimi i patentëshoferit. Hetuesit e IPK-së, në koordinim të plotë me Prokurorinë e Shtetit, do të vazhdojnë të ndërmarrin edhe veprime të tjera hetimore drejt ndriçimit të plotë të të gjitha rrethanave që ndërlidhen me këtë rast.

541 raste aktive me Covid në Gjilan

GJILAN, 21 PRILL (ER) - Komiteti për menaxhimin dhe parandalimin e përhapjes së Covid-19 në Gjilan, nën udhëheqjen e nënkryetarit Arbër Ismajli, ka mbajtur takimin për vlerësimin e situatës për dy ditët e fundit. Ismajli ka njoftuar se Gjilani aktualisht ka 541 raste aktive, kurse ka bërë me dije se 81 persona janë të shtrirë në spital, 61 prej të cilëve janë me oksigjeno-terapi. Ai u ka

bërë thirrje të gjithë qytetarëve që t'i respektojnë masat kundër përhapjes së Covid-19. Pasqyra e përgjithshme në Gjilan që prej fillimit të pandemisë është si vijon: prej 19 757 mostrave, 6 105 kanë rezultuar pozitivë, 5 433 janë shëruar, 133 qytetarë e kanë humbur betejën me virusin, 541 raste janë aktive, të shtrirë të infektuar me Covid janë 81 persona, 61 prej të cilëve me oksigjeno-terapi.



Begaj e Berisha panë nga afër mbjelljen e drunjve në qytetin e Malishevës

MALISHEVË, 21 PRILL (ER) - Të mërkurën ka filluar realizimi i projektit për mbjelljen e drunjve përgjatë rrugëve në qytetin e Malishevës. Fillimin e realizimit të këtij projekti e kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe nënkryetari Hajdin Berisha. Begaj e Berisha janë ndarë të kënaqur me fillimin e realizimit të këtij projekti për mbjelljen e drunjve në qytet. "Gjelbërimi

është jetë për një vendbanim dhe jam i kënaqur që jemi duke realizuar këtë, pasi sa më shumë gjelbërim në qytet, do të thotë më shumë jetë", ka thënë kryetari Begaj, përderisa u shpreh i kënaqur me realizimin e këtij projekti. Mbjellja e drunjve ka filluar në rrugën "Hamdi Berisha", ku do të mbillen rreth 200 drunj, ndërsa bazuar në tërë projektin, do të mbillen rreth 800 drunj në rrugët e qytetit në Malishevë.

Kryetari i Skenderajt bën homazhe te varri i dëshmorit Driton Veliu

SKENDERAJ, 21 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, deputetin Bekim Haxhiu dhe familjarë të dëshmorit, kanë bërë homazhe te varri i dëshmorit Driton M. Veliu, në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve në Marinë, në përvjetorin

e rënies heroike të tij. Para të pranishmëve kryetari Jashari ka thënë se e kanë për obligim që të jenë të bashkuar në mënyrë që ta jetësojnë amanetin e të rënëve për lirinë e Kosovës. "Dëshmorët dhe martirët e lirisë janë nderi dhe krenaria jonë e përjetshme", ka thënë Jashari.



Rreth 20 mijë persona vaksinohen kundër Covidit në Kosovë

Deri të mërkurën në nivel vendi janë vaksinuar rreth 20 mijë persona në Kosovë. Në këtë numër përfshihen punonjësit shëndetësorë, të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 PRILL - Koordinator për vaksinim në sallën '1 Tetori' në Prishtinë, Niman Bardhi, ka njoftuar të mërkurën se në nivel vendi janë vaksinuar rreth 20 mijë persona në Kosovë. Në këtë numër përfshihen punonjësit shëndetësorë, të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike. Sipas koordinatorit të kësaj qendre, aktualisht është duke u bërë vaksinimi i personave mbi moshën 75 vjeç, të shoqëruar me sëmundje

kronike. "Nga data 8 prill deri më sot janë vaksinuar mbi 2 930 persona. Nga ky numër mbi 1 311 kanë qenë të sëmurë kronikë, 191 profesionistë shëndetësorë, 1 261 të moshuar, por jo të shoqëruar me sëmundje kronike dhe 54 persona në dializë", ka thënë Bardhi. Sipas tij, në ditët në vijim do të shihet se për cilat kategori të personave do të vazhdojë vaksinimi.

Kosova ka nisur procesin e vaksinimit kundër koronavirusit më 29 mars, pas sigurimit të 24 000 dozave të vaksinës "AstraZeneca"

përmes programit COVAX të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili ka për qëllim shpërndarjen e vaksinave në vendet e varfra. Ky vend është thënë se do të pranojë edhe 76 800 doza të tjera të vaksinës "AstraZeneca" nga ky program në periudhën prill-qershor dhe mbi 100 000 doza të vaksinës "Pfizer/BioNTech" deri në fund të qershorit.

Në 24 orët e fundit, pesë të vdekur dhe 506 raste të reja me Covid në Kosovë

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me

metodën RT-PCR, si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT, janë testuar gjithsej 3 084 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 506 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Ferizaj një rast (62 vjeç), Gjakovë një rast (72 vjeç), Prishtinë një rast (70 vjeç), Viti një rast (59 vjeç), Vushtrri një rast (69 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 102 742 raste nga 508 333 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2.105 raste të

vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 761 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 89 141 raste, kurse numri i rasteve aktive është 11 496.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 86 raste, Mitrovicë 56 raste, Ferizaj 51 raste, Gjilan 49 raste, Podujevë 38 raste, Pejë 31 raste, Fushë-Kosovë 28 raste, Gjakovë 26 raste, Vushtrri 25 raste, Prizren 15 raste, Rahovec 12 raste, Viti 12 raste, Leposaviq 11 raste, Drenas 10 raste, Lipjan 10 raste, Kamenicë 9 raste, Obiliq 9 raste, Klinë 6 raste, Malishevë 6 raste, Kaçanik 4 raste, Hani i Elezit 3 raste, Deçan 2 raste, Shtime 2 raste, Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Skenderaj dhe Istog.



Kryhen pesë operacione kardiokirurgjike te fëmijët me defekte në zemër

Prishtinë, 21 prill (ER) - Në Klinikën e Kardiokirurgjisë në QKUK janë kryer pesë operacionet e para të fëmijët me defekte në zemër, po ashtu janë kryer edhe dhjetë stentime, zgjerim i enëve të

gjakut te fëmijët, në kuadër të Kardiologjisë Invazive. Këto shërbime janë kryer në mbështetje të misionit të Shoqatës Ndërkombëtare "Gift of Life" për trajtimin karidokirurgjik të fëmijëve të

Kosovës.

Të gjitha intervenimet janë kryer në bashkëpunim të plotë me stafin shëndetësor të klinikave të QKUK-së. Ekipi mjekësor, i cili do të qëndrojë në Kosovë deri në

fundjavë, përbëhet nga kardiokirurgët dr. Françesko Santoro dhe dr. Ribiera Santoro, nga kardiologët dr. Herbert Stern dhe dr. Roberto Tumbarello, me kolegë të tyre.



Policia kufitare parandalon kontrabandën me armë dhe mallra

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 PRILL - Departamenti i Policisë Kufitare, në vazhden e angazhimeve dhe planifikimeve operacionale, për luftimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale, përfshirë krimet trans-kufitare,

ka iniciuar disa raste penale: 'kontrabanda me mallra', 'import, eksport, furnizim, transportim, prodhim, këmbim, ndërmjetësim ose shitje e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse' dhe 'posedim i paautorizuar i substancave narkotike dhe psikotropike'. "Patrullat policore

të kufirit më 20.04.2021, rreth orës 21:30, gjatë vëzhgimit të kufirit me dylbi nate, kanë vërejtur dy kuaj duke lëvizur nga Maqedonia e Veriut në drejtim të Republikës së Kosovës (në drejtim të fshatit Dremjak). Patrullat policore kanë arritur t'i ndalojnë dy kuajt, të ngarkuar me mallra. Kuajt ishin të ngarkuar me njëqind kuti duhan të përpunuar (i grirë) dhe gjashtëmbëdhjetë thasë me duhan të përpunuar (i grirë). Sasia e duhanit të konfiskuar në këtë rast është 260 kilogramë, sasi kjo e cila është dorëzuar në Terminalin Doganor Hani i Elezit", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, pas realizimit të masave të fshehta të hetimit nga hetuesit policorë, më 21.04.2021, rreth orës 06:10, ka filluar zbatimi i urdhërësës për urdhër kontrollë të shtëpisë dhe objekteve të tjera përcjellëse të të dyshuarit B. H. (viti i lindjes 1978), i cili dyshohet për



përfshirje në veprën penale 'import eksport, shitje e armëve dhe municionit'. Gjatë realizimit të urdhërësës së kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar prova materiale. "Më 21.04.2021, rreth orës 03:00, gjatë kalimit të kufirit nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e Kosovës, një automjet të cilin e drejtonte D. G. (viti i lindjes 1990) është dërguar në vijën e dytë të

kontrollit. Gjatë kontrollit të ushtruar nga zyrtarë policore dhe ata doganorë tek i dyshuari është gjetur dhe janë sekuestruar dy qese najloni me nga 10 doza të dyshuara si substancë narkotike e llojit kokainë. Rasti është proceduar te Njësia e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Ministrja Nagavci: Fëmijët e verbër duhet të kenë mundësi të barabarta në shkollim

Pejë, 21 prill (ER) - Ministrja e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci, ka marrë pjesë të mërkurën në Qendrën Burimore për Mësim "Xheladin Deda" në Pejë, ku Ambasada e Çekisë ka dhuruar një donacion prej 19 mijë eurosh pajisje speciale për nxënës të verbër si, printer braili e makina braili, të cilat do t'u ndihmojnë këtyre nxënësve për mësimnxënie cilësore.

Nagavci ka falënderuar ambasadorin çek Pavel Bilek për mbështetjen e vazhdueshme për këtë qendër si dhe për donacionin e sotëm. Ajo ka thënë se fëmijët e verbër, por edhe secili fëmijë i Kosovës duhet të ketë mundësi të barabarta në shkollim. "E di që deri tash resurset nuk kanë qenë të mjaftueshme për secilin, por e sigurova menaxhmentin e kësaj qendre se prioritet imi si



ministre dhe i qeverisë Kurti 2 është ofrimi i mundësive të barabarta për secilin fëmijë. Ndaj në mandatin tonë qeverisë do të punësohen 400 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta duke rritur mundësinë për një arsim cilësor. Përveç obligimit, unë ndiej kënaqësi të madhe të punojë për ofrimin e mundësisë për shkollim për secilin nxënës pa dallim", ka thënë Nagavci.

KMShK-ja dhe AGK-ja kundërshtojnë që mediat online të jenë pjesë e ligjit për KPM-në

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) kanë pranuar me shqetësim raportimet se në Komisionin për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media të Kuvendit të Kosovës është përmendur edhe mundësia e rregullimit të përmbajtjes online të mediave nga ana e Komisionit të Pavarur për Media (KPM).

KMShK-ja, si mekanizëm vetëregullues që përfaqëson mediat e shkruara dhe online dhe AGK-ja, si organizatë që përfaqëson gazetarët, kundërshtojnë çdo përpjekje dhe çdo iniciativë, nga kushdoqoftë, për përfshirjen e përmbajtjes online të mediave si pjesë e mekanizmit rregullues

nga institucione shtetërore. "KMShK-ja është mekanizmi i vetëm në Kosovë që merret me etikën e mediave të shkruara dhe online (gazetat, mediat online, revistat, agjencitë e lajmeve) dhe vazhdimisht vendos për ankesat e qytetarëve dhe institucioneve në lidhje me shkeljet e etikës nga mediat e shkruara dhe online. Andaj KMShK-ja dhe AGK-ja kundërshtojnë fuqishëm çdo përpjekje dhe iniciativë për futjen e etikës së mediave të shkruara dhe online si pjesë e ligjit për KPM-në. Iniciativa të tilla janë në kundërshtim të hapur me rregullat ndërkombëtare të gazetarisë dhe frymën e gazetarisë të instaluar në Kosovë tash e një kohë. Secila nga mediat e

shkruara (online apo të shtypura) duhet të japin përgjegjësi për veprimet e tyre para organeve shtetërore, bazuar në ligjet përkatëse, por fillimisht vlerësimin e etikës së tyre nuk mund ta bëjë askush më mirë se vetë mediat për media, apo profesionistët e fushës", është thënë në komunikatën e përbashkët të KMShK-së dhe të AGK-së.

Në këtë komunikatë është bërë me dije se KMShK-ja nëpërmjet mekanizmit të kontrollit dhe vlerësimit të etikës së mediave të shkruara është njoftuar edhe nga vetë Kuvendi i Kosovës nëpërmjet Ligjit për Shpifjen dhe Fyerjen dhe vendimet që KMShK-ja merr për palët dhe për mediat respektohen dhe vlerësohen lart nga gjykatat



vendore në rastet kur ato vendosin për shpifjen dhe fyerjen. "Iniciativat për kontroll dhe vlerësim të etikës për mediat e shkruara dhe online nga një

organizatë shtetërore janë të dëmshme dhe nuk iu ndihmojnë mediave dhe gazetarëve", është thënë në komunikatën për media të KMShK-së dhe AGK-së.

Agron Llugaliu emërohet drejtor i përgjithshëm i Doganës

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka emëruar Agron Llugaliun drejtor të

përgjithshëm të Doganës së Kosovës. "Emërimi i Llugaliut pason përzgjedhjen nëpërmjet konkursit për drejtor të

përgjithshëm të Doganës së Kosovës, në një proces transparent dhe profesional të monitoruar nga përfaqësuesit

e Projektit Britanik për Rekrutime në Pozita të Larta Drejtuese", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



Kosova gjatë vitit 2020 rriti eksportin në 460 milionë euro

Drejtori i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, ka treguar se, pavarësisht prej pandemisë, gjatë vitit 2020 kompanitë e Kosovës arritën ta rrisin eksportin në 460 milionë euro. "Duke përcjell trendin e rritjes për tremujorin e parë të vitit 2021, ne presim që deri në fund të vitit eksportet të arrijnë shumë prej 650 milionë eurosh, apo një rritje prej 40-përqindësh", ka deklaruar Panxha



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 PRILL - Drejtori ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve, Astrit Panxha, ishte pjesë e panelit të diskutimit "Rritja e konkurrenshëmërisë eksportuese të NVM-ve kosovare përmes produkteve të shumëllojshme financiare" të organizuar nga USAID Kosovo Compete Activity, Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Gjatë adresimit të tij, drejtori i Klubit të Prodhuesve ka treguar se, pavarësisht prej pandemisë, gjatë vitit 2020 kompanitë e Kosovës arritën ta rrisin

eksportin ku në fund kishim eksport prej 460 milionë eurosh. "Kjo rritje ndodhi për shkak të shumë faktorëve, por një nga ta ishte edhe dështimi i zinxhirit të prodhimit me Azinë, ku disa kompani tonat e shfrytëzuan shumë mirë këtë mundësi. Duke përcjell trendin e rritjes për tremujorin e parë të vitit 2021, ne presim që deri në fund të vitit eksportet të arrijnë shumë prej 650 milionë eurosh, apo një rritje prej 40-përqindësh. Mirëpo për të pasur rritje të këtij sektori ekonomik duhet të ketë përkrahje si me grante, por edhe me mënyra të tjera të financimit", ka deklaruar ai.

Gjatë takimit u bisedua për mundësinë e mbështetjes

financiare për NVM-të e Kosovës të orientuara drejt eksportit në industrinë e përpunimit të drurit, TIK-ut dhe përpunimit të

ushqimit. Po ashtu, u bë prezantimi i shembujve ekzistues të iniciativave të ngjashme dhe shkëmbimi i

përvojave, por edhe koordinimi i donatorëve në lidhje me temën dhe identifikimi i mundshëm i veprimeve të sinkronizuara.

Bashkëpunimi në fushën e energjisë ishte pjesë e diskutimit në mes të Rizvanollit dhe ambasadorit norvegjez

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe zëvendësministri Mentor Arifaj kanë pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Norvegjisë në Republikën e Kosovës, Jens Erik Grondahl. Ministria Rizvanolli e ka falënderuar ambasadorin norvegjez për mbështetjen që Norvegjia i ka dhënë në vazhdimësi Kosovës, ndërsa e ka njoftuar mbi prioritetet e ministrisë lidhur me zhvillimin e ekonomisë së Kosovës. Ambasadori Grondahl e ka uruar ministren Rizvanolli për marrjen e detyrës së re dhe ka

theksuar se mirëpret bashkëpunimin me Qeverinë e Kosovës, duke besuar në një qeverisje të mirë dhe transparente.

Rizvanolli dhe ambasadori Grondahl diskutuan më gjerësisht për mundësitë e bashkëpunimit për energjinë, burimet e ripërtitshme dhe në fushën e teknologjisë, informacionit dhe komunikimit.

Ambasadori Grondahl ka theksuar se Norvegjia do të qëndrojë e përkushtuar për ta mbështetur Kosovën dhe për ta ndihmuar zhvillimin e saj ekonomik.



Banka Botërore vazhdon mbështetjen për sektorin e bujqësisë në Kosovë

PRISHTINË, 21 PRILL (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka zhvilluar të mërkurën një takim virtual me menaxherin e Bankës Botërore për Kosovë, Massimiliano Paolucci. Gjatë këtij takimi virtual është


diskutuar ecuria e Projektit të Bankës Botërore për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës bashkë me sfidat deri tek implementimi i objektivave dhe projektit në tërësi.


Ministri Peci ka njoftuar lidhur me synimet dhe objektivat

strategjike të Ministrisë duke filluar nga vlerësimet sektoriale, avancimi i legjislacionit dhe politikave publike për zhvillimin e punës në këtë sektor.

Nga ana tjetër, Massimiliano Paolucci ka falënderuar

ministren Faton Peci për vullnetin e shprehur dhe bashkëpunimin, si dhe për vizionin e qartë për arritjen e objektivave strategjike për zhvillimin e këtij sektori të rëndësishëm për zhvillim ekonomik.





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Llapi kualifikohet në finale të Kupës

Skuadra e Llapit e ka bërë hapin e madh drejtë realizimit të ëndrrës për pjesëmarrje në garat evropiane, pasi të mërkurën e ka siguruar kualifikimin në finale të Kupës. Llapi luajti baras me Prishtinën në ndeshjen kthyesë (2-2), derisa e kishte fituar ndeshjen e parë me rezultat 2-3



interesante ku të dyja skuadrat treguan lojë të mirë dhe si rezultat i kësaj u shënuan edhe katër gola. Vetëm gjashtë minuta i mjaftuan Prishtinës për të kaluar në epërsi, realizues nga penalltia ishte Enis Gavazaj. Llapi u rikthye në lojë pas dhjetë minutash duke e barazuar rezultatin me golin e sulmuesit Ahmed Januzi. Pjesa e parë u mbyllë me këtë rezultat. Në minutën e 64-të, Prishtina sërish kaloi në epërsi 1-2, por Llapi nuk u dorëzua dhe e barazoi rezultatin në minutën e fundit të kohës së rregull nëpërmjet Muhamed Hysenit. Trajneri i Llapit, Tahir Batatina ka thënë se skuadra e tij e meritoi kualifikimin në finale, pasi mposhti skuadra të forta si Ballkani, Trepça '89 dhe Prishtina. "E kemi ditur që nuk do të jetë lehtë, kualifikimi është ardhur falë punës angazhimit të

lojtarëve, mbi të gjitha kemi mposhtë Ballkanin, Trepçën '89, Prishtinën dhe jemi me meritë në finale. E kemi ditë që do ta kemi vështirë ndaj Prishtinës dhe sot na kanë vuri në vështirësi sidomos në pjesën e dytë, me rëndësi për ne ka qenë të kualifikohemi, sot ka ndikuar pak edhe pjesa e agjërimit – pasi

lojtarët nuk mund ta japin maksimumin shkak i agjërimit. Iu uroj të gjithë qytetarëve këtë kualifikim, dhashë Zoti që në këtë stadium ta sjellim trofeun e parë", ka thënë Batatina. "Shpresoj që finalja të jetë pas Ramazanit dhe të fitojmë dhe të shkojmë në garat evropiane, atë që e kam kërkuar për vite", ka shtuar Batatina. Prishtinës i mbetet të luftoj për titull në Superligë, derisa Llapi në finalen e madhe do të përballet me Dukagjinin e Klinës. Kjo e fundit e siguroi finalen pa e zhvilluar ndeshjen e dytë, pasi Istogu në ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin "Demush Mavraj" e kishte aktivizuar në lojë një lojtarë që nuk kishte të drejtë lojë për shkak të kartonëve. Fituesi i Kupës e përfaqëson Kosovën në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PODUJEVË, 21 PRILL - Skuadrës së Llapit i ka mjaftuar barazimi 2-2 kundër Prishtinës në ndeshjen kthyesë të gjysmëfinale për të siguruar kualifikimin në finalen e Kupës së Kosovës në futboll. Në fakt, Llapi e kishte fituar ndeshjen e parë që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 2-3 dhe kualifikohet me rezultat të përgjithshëm 5-4. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" ishte mjaftë

Kastrati: Nder dhe kënaqësi të luaja në Ligën Unike

PRISHTINË, 21 PRILL - Liga Unike, një ëndërr për shumë shqiptarë, u jetësua me turneun e Final 8 në Rahovec dhe Durrës, me skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria. Golden Eagle Ylli u kurorëzua me titullin e kampionit në edicionin e parë dhe historik, që njëkohësisht ishte edhe trofeu i parë në histori të klubit nga Theranda, kurse MVP u zgjodh Erjon Kastrati i Yllit. Erjoni në çerekfinale kundër Sigal Prishtinës shënoi 10



pikë për 16 minuta, ndërsa në gjysmëfinale kundër Goga

Basket kishte 10 pikë e dy kërcime për 28 minuta, kurse në

finale ndaj Pejës për 33 minuta kishte 21 pikë, pesë kërcime dhe një asistim. "Personalisht dhe si klub i kemi dhënë shumë rëndësi Ligës Unike. Ka qenë kënaqësi dhe nder i madh të radhitemi para flamurëve dhe të jemi një", është shprehur Kastrati për faqen zyrtare të Ligës Unike. Ai beson se kjo ligë do të ketë interesim edhe te sponsorët. "Shpresoj dhe besoj që Liga Unike në vitet e ardhshme do të ketë rëndësi më

të madhe sepse do të ketë ndeshje shumë cilësore, po ashtu do të jetë shumë interesante edhe për sponsorët", ka shtuar tutje basketbollisti i Kosovës.

Në fund foli edhe për çmimin MVP "Sigurisht se çmimi MVP ka rëndësi për arritjet e mia personale. Është si një shpërblim për punën dhe dedikimin që kam për basketboll, gjithashtu motiv shtesë edhe për të ardhmen", ka theksuar Kastrati.

Muhaxheri: Xhudistët janë ambasadorët tanë më të mirë

PEJË, 21 PRILL - Ekipi i xhudos, pas suksesit të madh që e arriti në Lisbonë të Portugalisë, të mërkurën është pritur nga kryetari i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri. Kryetari Muhaxheri është shprehur i kënaqur që ka takuar përfaqësuesit e ekipit të xhudos të cilët i ka vlerësuar si ambasadorët më të mirë. "Me kënaqësi kam pritur ekipin përfaqësues të xhudos dhe ambasadorët tanë më të mirë që

në fundjavë dolën të parët në Evropianin e mbajtur në Portugal. Kënaqësi e veçantë ta shohim Kosovën të renditur në mesin e 45 shteteve të Evropës, ku kampionë dolën Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova, kurse e bronzitë përfundoi Nora Gjakova dhe vendet e pesta i zunë Laura Fazliu e Lorianana Kuka. Pa dyshim që Peja është një qytet me histori dhe traditë!", ka shkruar Muhaxheri. Ndërsa trajneri Driton Kuka pas

këtij takimi ka thënë se është biseduar për avancimin e infrastrukturës së sportit të xhudos në qytetin e Pejës. "Medalistët e Evropianit u pritën nga i pari i Komunës së qytetit të Pejës Gazmend Muhaxheri. Biseduam për avancimin e infrastrukturës së sportit të xhudos në qytetin tonë. Peja, qyteti me kampione olimpikë, meriton të bëhet edhe qendër sportive me impakt të fuqishëm edhe për turizmin sportiv", ka



shkruar Kuka në profilin e vet në "Facebook". Distria Krasniqi dhe Akil Gjakova kanë fituar

medaljet e arta, kurse Nora Gjakova e ka fituar medaljen e bronzitë.



Përballja Joshua - Fury zhvillohet në Arabinë Saudite

LONDËR, 21 PRILL - Tashmë është caktuar edhe vendi se ku do të zhvillohet meçi i shumëpritur mes Anthony Joshuas dhe Tyson Furyt. Meçi mes tyre do të zhvillohet në Arabinë Saudite, në kohën kur edhe

do të mbahen Lojërat Olimpikë Verore. Kjo është konfirmuar nga promoteri i Joshuas, Eddie Hearn. Ende nuk është caktuar data e këtij meçi, teksa besohet se 24 korriku mund të jetë data më e përshtatshme.

"Ne nuk kemi finalizuar një datë të saktë, 24 korriku është data e përafërt, por mund të dalë në fillim të gushtit, por jo më vonë se kaq", ka deklaruar Hearn. Joshua dhe Fury do të luftojnë për titullin e padiskutueshëm të botës.

Çeferin: Klubet e rikthyera kanë shumë për të dhënë

NYON, 21 PRILL - Pas tërheqjes së klubeve "rebelë" nga projekti për krijimin e Superligës, UEFA ka ndryshuar tonet dhe qëndrimin e saj. Nga

kërcënimet për përjashtim, në reagimin e tij presidenti Alexander Çeferin ka shtrirë i pari dorën e bashkëpunimit. "Dje thashë se është diçka për t'u admiruar kur pranon se ke

gabuar dhe këta klube kanë bërë një gabim të madh. Por tani janë kthyer në grup dhe e di që kanë shumë për të dhënë, jo vetëm në kompeticionet tona, por për

të gjithë futbollin evropian. Tani gjëja më e rëndësishme është të shkojmë përpara dhe ta rindërtojmë unitetin që gëzonte më parë ky sport", ka thënë presidenti i UEFA-s.



Mbesin vetëm tri klube, Superliga Evropiane nuk mund të jetësohet

TORINO, 21 PRILL - Themeluesi i Superligës Evropiane dhe presidenti i Juventusit, Andrea Agnelli, ka thënë se liga e shkëputur nuk mund të jetësohet për shkak se gjashtë klubet angleze u tërhoqën nga ajo. Andrea Agnelli e ka pranuar se ka dështuar përfundimisht Superliga Evropiane, e cila për synim kishte ta zëvendësonte Ligën e Kampionëve si garën kryesore evropiane për klube. I pyetur nëse ende ka gjasa që projekti i tyre të realizohet pas largimeve, Agnelli për Reuters ka thënë: "Të jem i sinqertë me ju, jo, përfundimisht nuk do të ndodhë". Vetëm pak orë më parë Superliga ishte zotuar se do ta ndryshonte projektin pasi planet e tij nisën të dështonin. "Me gjithë njoftimin për largim të klubeve angleze, të cilat u detyruan ta marrin një vendim të tillë për shkak të presionit ndaj tyre, ne jemi të bindur se propozimi ynë është plotësisht në përputhje me ligjin dhe rreg-



ulloret evropiane, siç u vërtetua sot nga një vendim i gjykatës për ta mbrojtur Superligën nga veprimet e palës së tretë. Duke i marrë parasysh rrethanat e tanishme, ne do t'i rimendojmë hapat më të përshtatshëm për ta ndryshuar projektin, gjithmonë duke i pasur në mendje synimet tona për t'iu ofruar tifozëve përvojën më të mirë të mundshme", thuhet në njoftimin e Superligës.

Ky njoftim erdhi pasi Manchester City, Manchester United, Chelsea, Liverpool, Arsenal dhe Tottenham u tërhoqën. Po ashtu edhe dy klubet italiane, Interi dhe Milani, janë tërhequr sikurse edhe Atletico Madrid. Deri tani vetëm Juventus dhe dy klubet spanjolle, Real Madridi dhe Barcelona, kanë mbetur pjesë e saj.

Clippersat vazhdojnë me formë të mirë, Brooklyn mposhti New Orleansin

PORTLAND, 21 PRILL - Los Angeles Clippers vijon të shfaqë formë të mirë në këtë fazë të fundit të sezonit të rregullt të NBA-së. Skuadra kaliforniane, e udhëhequr nga Paul George, autor i 33 pikëve dhe 11 "reboundeve", fituan 113-112 ndaj Portland Trail Blazersit në një sfidë shumë të luftuar e që u vendos në sekondat e fundit, me McCollum që nuk mundi të realizonte në gjuajtjen e fundit, e cila do t'i jepte suksesin Blazers. Edhe pse vazhdon ta ndiejë mungesën e Kevin Durantit e të James Hardenit, Brooklyn Nets triumfoi 134-129 kundër New Orleans Pelicansit. Sfidë kjo qëanoi më shumë nga spektakli sesa nga loja mbrojtëse. Te Netsi spikati me 32 pikë Kyrie Irving, ndërsa për të zotët e shtëpisë nuk mjaftuan 33 pikët e Zion



Williamson. Vjen fitorja e shtatë radhazi për New York Knicksin, aktualisht të pestët me Konferencën e Lindjes, që iu imponua 109-97 Charlotte Hornetsit. Vendimtar me 24 pikë RJ Barrett, ndërsa për Hornetsin

më i miri rezultoi PJ Washington me 26 pikë. Atlanta Hawks vazhdon të tregojë formë të mirë, duke fituar 112-96 ndaj Orlando Magicut falë 25 pikëve të Trae Youngut dhe "double-double" të Clint Capelasit, që e mbylli takimin me 14 pikë dhe 19 "rebounde". Sukses edhe për Minnesota Timberwolvesin përballë Sacramento Kingsit me rezultatin 134-120. Spikati me 28 pikë "rookie" Anthony Edwards, pa harruar edhe 26 pikë e 18 "rebounde" të Karl-Anthony Townsit.

REZULTATET

Atlanta Hawks - Orlando Magic	112-96
New Orleans Pelicans - Brooklyn Nets	129-134
New York Knicks - Charlotte Hornets	109-97
Portland Trail Blazers - Los Angeles Clippers	112-113
Sacramento Kings - Minnesota Timberwolves	120-134

Al Khelaifi: Mbappe qëndron në PSG

Kylian Mbappe mbetet një emrat më të lakuar në tregun e transferimeve, në një kohë kur sulmuesi francez është ende i paqartë për të ardhmen. Fakt është që Reali e ka vendosur prej kohësh

në majën e listës së dëshirave, presidenti Perez nuk e ka fshehur kurrë simpatinë për Mbappe dhe nuk e përjashton mundësinë për të bërë një tjetër lëvizje gjatë merkatos së verës. PSG-ja nga ana e

tij i ka vendosur prej kohësh në tavolinë një "chek të bardhë" dhe opsionin për ta rinovuar kontratën, por Mbappe vijon të hezitojë, pikërisht ky detaj ka bërë që mediat të flasin në mënyrë konstante

për të ardhmen e sulmuesit francez. Nuk ka asnjë dyshim në lidhje me këtë temë presidenti i PSG-së, sheiku Nasser Al Khelaifi: "A do të qëndrojë Mbappe te PSG-ja? Po, e sigurt".

SHKURT

Celtic interesohet për Mourinon

Vetëm disa ditë më parë Jose Mourinho u shkarkua nga Tottenhami por, mesa duket, "The Special One" nuk do të qëndrojë për shumë kohë pushim. Edhe pse aventura e tij londineze nuk shkoi në mënyrën më të mirë të mundshme, portugezi mbetet sërish një nga trajnerët më të kërkuar. Sipas raportimit të "The Sun", Mourinho është një nga pretendentët për ta marrë drejtimin e Celticit për sezonin e ardhshëm. Kujtojmë që klubi skocez drejtohet përkohësisht nga ish-lojtari i tyre, John Kennedy, pas largimit të ish-trajnerit Lennon në muajin shkurt. Megjithatë, deri më tani favorit është ish-tekniku i Bournemouthit, Eddie Howe, por nuk përjashtohet pista Jose. Mbetet për t'u parë se cila do të jetë zgjedhja e Celticut për stolin, por edhe destinacioni i radhës për Mourinon.

Rossi: Sezon i vështirë, po provoj çdo mënyrë për t'ia dalë mbanë

Sezoni 2021 i MotoGP nuk ka nisur aspak mirë për pilotin italian Valentino Rossi, që deri më tani ka zhgënjyer, në garën e fundit të zhvilluar në Portugali ai u rrëzua, duke mos e mbyllur dot atë. "Një mëkat", pasi do të merrnim pikë të rëndësishme për moral dhe për skuadrën", ka thënë Rossi. "Sot është e vështirë të bësh një hap të madh përpara, pasi çdo pistë është ndryshe nga tjetra dhe ka karakteristikat e saj. Fakti që nisem nga vendet e fundit më penalizon, pasi nuk arrij të jem i shpejtë dhe humbas kohë në grupin e pilotëve. Të jem i sinqertë, prisja të isha më kompetitiv", u shpreh Rossi. "Po i provojmë të gjitha mënyrat për t'ia dalë mbanë, por nuk kemi shumë sukses. Nuk jemi ende aq të shpejtë sa dëshirojmë. Ky vit do të jetë një sfidë e vështirë për mua, por nuk duhet të mërzhitemi. Nëse arrij të paraqitem ashtu si dëshiroj, mund të jemi më kompetitivë", ka deklaruar Rossi.

E ardhmja e Youngut, larg Interit

E ardhmja e Ashley Youngut duket se do të jetë larg Serisë A. Mbrojtësit i skadon kontrata në fund të sezonit me Interin dhe drejtuesit e klubit zikaltër, për momentin, nuk i kanë ofruar rinovimin e kontratës. Sipas mediave italiane, 35-vjeçari me shumë mundësi gjatë mekatos së verës do të rikthehet në kampionatin anglez te Watfordi, skuadër në të cilën ai është promovuar si lojtar.

Silva mund të jetë zëvendësues i Haalandit

Skuadra e Borussia Dortmundit është duke menduar për zëvendësuesin e Erling Haalandit. Sipas mediave gjermane, Dortmundi e ka piketuar sulmuesin e Eintracht Frankfurtit, Andre Silva. Forma e mirë e 25-vjeçarit portugez ka rënë në sytë e Dortmundit, prandaj janë gati t'i paguajnë Frankfurtit shumën prej 40 milionë eurosh. Portugezi ka luajtur me sukses edhe për Porton, Sevillan dhe Milanin.



Hysen Beqa lindi në Mollë të Gjakovës. Ka mbaruar studimet për shkencë politike dhe administratë publike në Universitetin e Prishtinës. Beqa është autor i romanit "Misiri i vogël", i cili nga gjuha shqipe është përkthyer në gjuhën angleze, franceze, gjermane, italiane dhe polake. Ky është libri i tij i dytë.

Ky libër, në rrafshin tematik, është vazhdim i romanit *Misiri i vogël*, i po të njëjtit autor, botuar tri vjet më parë, në të cilin autori përsiat për veten, për shoqërinë, për botën që e rrethon.

Këtë libër herë e lexojmë si fikcion, herë tjetër si jetëshkrim. Brenda tekstit gjejmë shenja të autorit, por edhe të narratorit. Ato që i rrëfen narratori janë ide të autorit, janë përkëpamje të tij për individët dhe shoqërinë. Heroi i romanit gjendet para shumë dilemave të mëdha të cilat ia krijon shoqëria.

Në këtë libër autori trajton fatin e shkrimtarit dhe ballafaqimin e tij me shoqërinë. Përmes ndodhjeve personale, del sheshit fati i shkrimtarëve në shoqërinë e Kosovës. Nëse dikur shkrimtari ishte prijës popullor, sot ai është shtresë e harruar nga shoqëria madje, nëpërmjet gojës së narratorit homodiegetik, shkrimtarët konsiderohen të çmendur dhe janë ose bëhen objekt talljeje. Por, nëpërmjet stoicizmit të narratorit Beqa mëton të tregojë se shkrimtaria nuk është thjesht një profesion a pasion, por mision.

Në këtë libër do të lexoni për politikën dhe për politikanët. Nuk do ta hasni autorin duke bërë politikë. Edhe pse nuk përmend emra të politikanëve dhe të politikave të këqija, është mjaft konkret, sepse përmend specifika të tyre. Këto raste të trajtuara për lexuesin semantik janë thjesht ide personale, kurse për lexuesin semiotik më tepër se kaq.

Albin Mehmeti

5.99€



SHKRIMTARI

HYSEN BEQA

HYSEN BEQA



Kaltrina Pacolli
Prishtinë

Zërin ngrite deri te Zoti.

Jetën mos ia fal askujt, përpos vetes.

Ti vlen sa gjithë bota, dhe bota pa ty është e mjerë.

Ti që botës i dhuron jetë, askush nuk ka të drejtë ta marrë atë nga ti.

Bërtit! Fol! Thuaje!

Unë jam gruaja më e fortë në botë!

ISBN 978-9951-780-49-0




9 789951 780490

6.99€



UNË, KUFOMA E ARDHSHME



Kaltrina Pacolli

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "FRIENDS N'SHESH" SH.P.K. me pronar Shqipdon Zeneli, ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811445479 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "FRIENDS N'SHESH" D.O.O. Shqipdon Zeneli, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811445479, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "FRIENDS N'SHESH" L.L.C. Shqipdon Zeneli, has come to the decision to quit its nr. 811445479, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Skyvision" SH.P.K. me pronar Artan Pllana, ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 811506552 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Skyvision" D.O.O. Artan Pllana, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811506552, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Skyvision" L.L.C. Artan Pllana, has come to the decision to quit its nr. 811506552, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionarët e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar Shala Soccer L.L.C. me numër unik identifikues: 810063769 me seli në Prishtinë, Lagjia: Dardania Rr. Mustafa Venhari nr.69/6 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Femzi Bahtiri me ID: 1001062146 nga Prishtina, Lagjia Kalabria. Adresa: Rr. Agim Qela me tel: 049/550-521 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të përcaktuara dhe raporte Kreditore-Debitorë në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

Te lutem shpalle ne gazet ne 1/8 te faqes se gazetes.

Teksti i shpalljes te eshte ne origjinal si e kam dergu une.(mos e ndrro).

Në shpalljen e sotit më është përvjedhur një gabim te ligji kështu që më duhet me përsërit

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Nurhan Tashica shpall të pavlefshme diplomën shmlt "Arkitekt Sinani" Mitrovicë.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit nr.60 të datës 26.03.2021, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësim të vendit të punës në kohë të caktuar, KRM "Uniteti" Sh.A vendosi që me datë 21.04.2021 të shpallë;

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

Zyrtar/e Administrativ/e

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë

- Kryen të gjitha punët e asistentit të cilat i përcakton Bordi i Drejtorëve
- Mban evidencën zyrtare të thirrjeve telefonike dhe takimeve.
- Pranon thirrjet dhe shkresat, kryen punët kompjuterike nga fushëveprimtaria e punëve dhe detyrave të punës, si dhe punë tjera teknike që i caktonë Bordi i Drejtorëve, siq janë shumëzimi dhe fotokopjimi i materjaleve, arkivimi i dokumenteve dhe të postës për dorzim intern dhe ekstern, i të njejtave.
- Nëse është nevojë edhe qëndriminë më të gjatë se orari i rregullt i punës në raste të veçanta. Si dhe punë tjera të kësaj natyre, të cilat i përcaktonë sipas urdhërësësë

Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë Diplomë Universitare;
- CV-në
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muaj do të jetë në punë provuese.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 21.04.2021 deri më datën 07.05.2021. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

